



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.35/2016

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së Kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual **Naim Mehollı**, në çështjen juridike të paditëses: nga kundër të paditurit: : "Dr. tē cilin e përsaqëson sipas autorizimit me shkrim, baza e kontestit: **Kompensim i pagave përcjellëse dhe shpërbimit jubilar, në seancën e datës: 08.06.2017, konform nenit 148 të LPK-së bijën këtë:**

A K T G J Y K I M
- nē bazē tē pohimit -

- APROVOHET** në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e Bazuar dhe
 - OBLIGOHET** i padituri
në Mitrovicë që në emër të dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe një për shpërblimi jubilar për katërdhjet vjetorin e punës tia paguaj paditëses
shumën prej 1226 94 euro në llogarinë me nr. 1226 94
ga Mitrovica
Banken ne
brenda afatit 15 ditor nga ditë e pranimit të
këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm,
 - OBLIGOHET** i padituri që në emër të takstsës përvendim Gjykatës tia paguaj shumën prej 20 euro në afatit 15 ditor nga ditë e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja , nga Mitrovica me datë: 20.01.2016 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurit

' ne Mitrovice, për pagës të dy pagave për shpërbillim jubilar dhe dy paga përcjellëse.

Gjykata ka mbajtur seancën me datë: 08.06.2017 . Në këtë seancë pala paditëse deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë, e beje precizimin e kërkesëpadisë kështu që shuma e përgjithshme duhet te jete ne lartësi prej tri 3 (tri) pagave ne vlerë prej 1226.94 euro sikurse ne petitum te kërkesëpadisë pasi që një page tashme me është paguar me rastin e daljes ne pension.

Përsaqësuesi i të paditurit në seancë deklaroi se padinë dhe kërkesëpadinë nuk e kundërshtoi për arsyje se paditësja bazuar në marrëveshjen e përgjithshme kolektive te datës 18.03.2014 e që ka hyre ne fuqi prej datës 01.01.2015 ka te drejte sipas nenit 53 te marrëveshjes se përgjithshme kolektive te Republikës se Kosovës te datës 18.03.2014.

Meqenëse kërkesëpadia e paditëses nuk u kundërshtua në aspektin e bazës nga ana e përsaqësuesit të të paditurës, gjykata pa shqyrtim të mëtejmë mori aktgjykim në bazë të pohimit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi se pohimi i kërkesëpadisë nuk është në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK-së, dhe pa shqyrtim të mëtejmë në procesverbal në prezencën e palëve ndërgjyqëse mori aktgjykim në bazë të pohimit.

Andaj duke u bazuar në nenit 148 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE,
C.nr. 35/2016 Me dt. 08.06.2017.

G J Y Q T A R I ,
Naim Mehollı

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka te drejtë ankese në afat 15 ditore nga dita e pranimit të të njëjtë, Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit nëpërmjet kësaj gjykate.